



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot .

Datë ____ .03.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Karburant”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Naftë 09134000-7
- Benzinë 09132000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 32,965,644 (tridhjetë e dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë PA TVSH.

Ose 330,781 (treqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) Euro, pa TVSH.

Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marrë 3 (tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke përlllogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi parë pika b) ,të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Korçe** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik,

të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se **40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4. Ofertuesi duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Për sa më sipër duhet të paraqesë : Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregeti me pakice të lendeve djegëse Karburante” ose Licence për tregtimin me pakice të karburanteve, gazit të lengshëm naftes për automjet, vajrave lubrifikant për përdorim nga konsumatorët fundorë” të lëshuar nga Bashkia Korçë.

Argumentimi: “Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjin Nr.8450, dat 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450, Datë 24.2.1999 “Per përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe në V.K.M Nr. 129, datë 18.03.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me V.K.M Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi.

2.5 Raport analize të cilësive të karburantit (naftë) të leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknike dhe Industrial (ISHTI). Raport analiza duhet të jetë leshuar brenda 6 muajve nga data e hapjes së tenderit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, gërma c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Kriteri i mësipërm u vendos me qëllim që të vërtetohet se nafta që operatori tregëton është konform standartit të kërkuar në specifikimet teknike.”

2.6 Ofertuesi duhet të paraqesë deklarate se ofron shërbimin nëpërmjet kartës elektronike në përputhje me VKM Nr 561 datë 29.07.2016.

Argumentimi: : Ky kriter është vendosur bazuar në VKM Nr.561, datë 29.7.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të karburantit të parashikuar për çdo mjet që do të furnizohet.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e referencës, sasitë, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr.79 datë 18.03.2025.

Specifikimet:

NAFTE

Specifikime Të dhënat teknike të Gazoil duhet ti referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar SSH EN 590:2022.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kerkuara sipas standartit të kerkuar si me sipër:

Kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara	
		minimale	maksimale
Numri i cetanit		51,0	-
Indeksi i cetanit		46,0	-
Densiteti në 15 °C °	kg/m ³	820,0	845,0
Hidrokarburët aromatikë policiklikë	% (m/m)	-	8,0
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
Pika e flakërimit	°C	55	-
Mbetja e karbonit (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010
Pika e bllokimit të filtrit në te ftohte CFPP	°C	-	-
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vleresimi	Klasa 1	
Përmbajtja e esterit të metilit të acidit yndyror (FAME)	% (V/V)		7,0
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50
Përmbajtja e ujit	%m/m	-	0.020
Lubricitetit, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60°C	µm	-	460
Pika e turbullimit	°C	-	-
Ndotja e përgjithshme	mg/kg	-	24
Qëndrueshmëria ndaj oksidimit	g/m ³	-	25
Distilimi : distilati që vlon në 250°C,% (v/v) distilati që vlon në 350 °C,%(v/v) distilati që vlon në 95 % (v/v)	% (V/V) % (V/V) °C	85	65 360

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi i mjeteve të transportit do të bëhet sipas kërkesave të institucionit perkates në cdo orë të dites a të nates,gjate gjitha javes.

Sherbimi i furnizimit me karburant per mjetet e transportit do te kryhet vetem nepermjet kartes elektronike me te cilen mundesohen identifikimi i mjetit dhe perdoruesi i saj.

Kontraktuesi se bashku me faturen e mallit qe do te paraqitet per likujdim duhet te paraqese edhe flete analizat per karburantet e kerkuar nga autoriteti kontraktor.

BENZINE

- Specifikime Të dhënat teknike të Benzines duhet ti referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar SSH EN 228:2012 + A1:2017.

Operatorët ekonomike janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kerkuara sipas standartit të kerkuar si me sipër:

Kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Treguesi Cilësor	Njësia e matjes	Norma e lejuar	
		Minimale	Maksimale
Numri i oktanit kërkimor, RON		95,0	-
Numri i oktanit motorik, MON		85,0	-
Densiteti (në 15 °C)	kg/m³	720,0	775,0
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë / 50°C)	Renditje	klasa 1	
Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
Distilimi			
a.Distilon deri 70°C	% (V/V)	20	48
b.Distilon deri 100°C	% (V/V)	46,0	71,0
c.Distilon deri 150°C	% (V/V)	75	-
d.Pika finale e distilimit	°C	-	210
e.Mbetjet e distilimit	% (V/V)	-	2
Përmbajtja e tipit të hidrokarburit			
a.Olefinat	% (V/V)	-	18
b.Aromatiket	% (V/V)	-	35
Permbajtja e benzenit	% (V/V)	-	1
Përmbajtja e oksigjenit	% (m/m)	-	3.7
Përmbajtja e komponimeve oksigjenore			

a	Methanol (alkool metilik)	% v/v	-	3
b	Etanol (alkool etilik)	% v/v	-	5
c	-Alkool izoprofilik - Alkool izo butilik -Alkool terc butil -Etere (me 5 ose me shume atome C) -Komponime oksigjenore te tjera			Perzierja ne vellim i kufizuar ne 2.7% (m/m) te permbajtjes maksimale te oksigjenit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizimi i automjeteve do te behet sipas kerkeses te autoritetit kontraktor.

Sherbimi i furnizimit me karburant per mjetet e transportit do te kryhet vetem nepermjet kartes elektronike me te cilen mundesohen identifikimi i mjetit dhe perdoruesi i saj.

Kontraktuesi se bashku me faturen e mallit qe do te paraqitet per likujdim duhet te paraqese edhe flete analizat per karburantet e kerkuar nga autoriteti kontraktor

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi :Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me karburant.

Kontraktuesi duhet te furnizojë me karburant ne perputhje me standartet e kerkuara dhe specifikimet teknike.

Afati: 12 muaj nga data e lidhjes se mareveshjes kuader.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sasite janë kërkuar për të përmbushur nevojat e ndërmarrjes në mënyrë të plotë për realizimin e shërbimeve në interes të komunitetit.

NJËSIA E PROKURIMIT